

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Xhinos” Sh.p.k.

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Kodin Civil, në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërítë Tregtare” i ndryshuar, dhe në ligjin Nr. 9723, datë 3.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, i nënshkruari si vijon:

- “**Sada Platts Group**” Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, në Shqipëri, me numër unik identifikimi M41409021F, me seli të regjistruar në adresën: Rruga Barrikadave (Rruga Çerçiz Topulli), ZK.8360, Godina Nr.15, Hyrja A, Kati 1 dhe 2, Njësia Bashkiake Nr.8, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga **Znj. Abigail Joyce Platts**, shtetase Britanike, me numër pasaporte 124639558, në cilësinë e administratorit të shoqërisë;

në cilësinë e Ortakut të vetëm të shoqërisë, me vullnet të plotë e të lirë nënshkruan, sot më datë 29.08.2024, Akt Themelimin (*të inkorporuar në këtë Statut*) me qëllim themelimin e kësaj shoqërie sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

KREU I

**EMRI, FORMA, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA, KOHËZGJATJA DHE
KAPITALI THEMELTAR**

NENI I

Emri i Shoqërisë, Data e Themelimit dhe Themeluesit

- Emri i shoqërisë është “Xhinos” Sh.p.k.
- Shoqëria themelohet më datë 29.08.2024 në Tiranë, Shqipëri.
- Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.
- Themeluesi i shoqërisë është:
 - “**Sada Platts Group**” Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, në Shqipëri, me numër unik identifikimi M41409021F, me seli të regjistruar në adresën: Rruga Barrikadave (Rruga Çerçiz Topulli), ZK.8360, Godina Nr.15, Hyrja A, Kati 1 dhe 2, Njësia Bashkiake Nr.8, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga **Znj. Abigail Joyce Platts**, shtetase Britanike, me numër pasaporte 124639558, në cilësinë e administratorit të shoqërisë.



NENI II

Forma Ligjore

- 2.1. Shoqëria "Xhinos" Sh.p.k., (këtu e në vijim referuar si "Shoqëria") është e themeluar dhe organizuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe aktiviteti i saj rregullohet nga ky Statut dhe ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.
- 2.2. Shoqëria do të operojë në përputhje të plotë me ligjet në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

NENI III

Objekti i Veprimitarisë

- 3.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktivitetave që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimit të barit, restorantit dhe kafenesë, si dhe të gjitha veprimitaritë shtesë në lidhje me sa më sipër.
- 3.2 Shoqëria mund të ndërmarrë dhe kryejë edhe aktivitete të tjera në Shqipëri dhe jashtë saj, të cilat nuk janë të parashikuara në pikën 1 të nenit 3, por që janë të nevojshme dhe të domosdoshme në përbushjen e objektit të veprimitarisë.

NENI IV

Selia

- 4.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Pasuria e llojit njesi, me sipërfaqe 261.09 m², e ndodhur në katin zero të Qendrës Tregtare "Rainbow Center", Rruga Vaso Pasha – Pjetër Bogdani, Tiranë, Shqipëri.
- 4.2 Vendimi për transferimin e selisë së Shoqërisë është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme.
- 4.3 Çelja e degëve dhe zyrave të përsaqësimit në qytete të tjera ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të kryhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë edhe mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjeter.

NENI V

Kohëzgjatja

- 5.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pacaktuar.

NENI VI

Kapitali Themeltar

- 6.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 000 (njëqind mijë) Lekë.
- 6.2. Numri total i kuotave është 1 (një).
- 6.3. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e Shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre të mëposhtëm:
 - a) **“Sada Platts Group” Sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, në Shqipëri, me numër unik identifikimi M41409021F, me seli të regjistruar në adresën: Rruga Barrikadave (Rruga Çerçiz Topulli), ZK.8360, Godina Nr.15, Hyrja A, Kati 1 dhe 2, Njësia Bashkiake Nr.8, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Znj. Abigail Joyce Platts, shtetase Britanike, me numër pasaporte 124639558, në cilësinë e administratorit të shoqërisë, e cila zotëron 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme 100 000 (njëqind mijë) Lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
- 6.4. Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjestim të drejtë me pjesëmarrjen që zotërojnë në kapitalin e Shoqërisë. Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta për të nënshkruar pjesën e tyre, kapitali i panënshkruar mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë sërisht të drejtën e nënshkrimit të kapitalit, në përpjesëtim të drejtë me aksionet e pjesëmarrjes në shoqëri.
- 6.5. Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë dhc/ose zvogëlojë Kapitalin Themeltar në çdo moment, të konsideruar të nevojshëm për të realizuar qëllimin e themelimit të Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mund të emetojë kuota me vendimmarjen prej të paktën 75% të ortakëve që zotërojnë kuota me të drejtë vote.
- 6.6. Kuota mund të shitet, dhurohet ose transferohet palëve të treta nga Asambleja e Përgjithshme me vendimmarjen prej të paktën 75% të ortakëve që zotërojnë kuota me të drejtë vote.
- 6.7. Nëse kuotat zotërohen nga dy ose më shumë ortakë dhe njëri prej tyre dëshiron të shesë, dhurojë ose transferojë kuotat e tij, ai duhet të respektojë të drejtën e parablerjes. Në raste të tillë, përparësia e parë do t'i jepet ortakut që zotëron përqindjen më të madhe të kuotave, i ndjekur nga ortakët e tjerë në rend zbritës sipas përqindjeve të tyre të pronësisë.

KREU II

ORGANET E SHOQËRISË

NENI VII

Asambleja e Përgjithshme

- 7.1. Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vndos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akt Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.
- 7.2. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij, si dhe të votojë në përputhje me të drejtat që rrjedhin nga kuota që zotëron, apo pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri. Të drejtën e votës në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme e kanë vetëm ortakët të cilët zotërojnë kuota me të drejtë vote.
- 7.3. Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjeter ose nga një përfaqësues i deleguar me prokurë me shkrim.
- 7.4. Ortaku nuk mund të delegojë të drejtën e votës për një pjesë të kuotave të tij të kapitalit, nëse ai voton personalisht për pjesën e mbetur.
- 7.5. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (conference call) audio ose video, në përputhje me legjislacionin për shoqëritë tregtarë dhe komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari i saj apo Sekretari i mbledhjes (të caktuar sipas rastit), me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali përkatës.
- 7.6. Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori/ët ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 25% të kapitalit të Shoqërisë. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e banimit, në adresat e email, ose në adresat e tjera të njoftuara Shoqërisë (nëse janë njoftuar të tjera), të paktën 10 (dhjetë) ditë përpëra datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njofumi duhet të përbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.
- 7.7. Asambleja e Përgjithshme do të konsiderohet e mbledhur rregullisht, pavarësisht nga sa më sipër, në rast se të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord për rendin e ditës.
- 7.8. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohej nga Administratori/ët, ose nga ortakët që zotërojnë kuota me të drejtë vote, të caktuar sipas rastit. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje midis personave të pranishëm.
- 7.9. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhë të firmosen nga Kryetari dhe Sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
- 7.10. Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit finanziar.
- 7.11. Vendimet e vlefshme nga Asambleja e Përgjithshme kërkojnë miratimin e të paktën 75% të totalit të kapitalit të zotëruar nga ortakët me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre. Nëse



4

ky prag nuk plotësohet, Asambleja e Përgjithshme thirret për një mbledhje të dytë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbledhja fillestare.

- 7.12. Asambleja e Përgjithshme vendos me vendimmarjen e 75% të ortakëve me të drejtë vote, ose përfaqësuesit e tyre, për ndryshimin e këtij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.
- 7.13. Asambleja e Përgjithshme është kompetente për cështjet e mëposhtme:
- a) Ndryshimet dhe shtesat e Statutit të Shoqërisë;
 - b) Zmadhimin dhe/ose Zvogëlimin e kapitalit themeltar;
 - c) Blerjen, Bashkimin, Shkrirjen, Transformimin dhe procesin e Likuidimit të Shoqërisë;
 - d) Emërimin dhe Shkarkimin e Administratorit;
 - e) Emërimin dhe Shkarkimin e Kontabilistëve të Certifikuar, Miratimin e Pasqyrave Financiare pas verifikimit nga Kontabilisti i certifikuar;
 - f) Emetimin e kuotave;
 - g) Emërimi i Likuiduesve në rast të procesit të likuidimit përvec rasteve të falimentimit;
 - h) Përcaktimin e pagës, bonuseve si dhe kohëzgjaljen e emëritit të Administratorit;
 - i) Çështje të tjera në ngarkim të Asamblesë nga ligji dhe ky Statut.

NENI VIII

Administratori

- 8.1. Administratori i parë i Shoqërisë "Xhinos" Sh.p.k. emërohet Znj. Naime Balaj, shtetase Shqiptare dhe mbajtëse e lëtërnjoftimit me Nr. Personal J36030012N, lindur më 30.10.1993, në Bajram Curri dhe banuese në Tiranë në adresën: Vilat Gjermane, Rr. Fuat Toptani, Tiranë, Shqipëri, për një periudhë 5 (pesë) vjecare, duke filluar nga 29.08.2024 – 28.08.2029, me të drejtë rizgjedhjeje.
- 8.2. Shpërbimi për Administratorin caktohet nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë. Për Administratorin, si dhe për të gjithë punonjësit e tjerë, Shoqëria është e detyruar të paguajë sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.
- 8.3. Shoqëria administrohet nga një apo më shumë Administratorë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh. Administratori mund të rizgjidhet dhe shkarkohet në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme.
- 8.4. Administratori zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektit të Shoqërisë, përvëç atyre që ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statut i'a rezervon Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë.
- 8.5. Administratori vepron në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori eshtë përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë. Administratori mund të delegojë persona të tretë për kryerjen e veprimeve dhe

akteve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë, duke mbajtur përgjegjësi për të gjitha veprimet e kryera nga të tretët e deleguar për administrimin e Shoqërisë.

8.6. Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti interesit, Administratori do të njoftojë menjëherë ortakët si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

8.7. Administratori është përgjegjës për:

- a) Manaxhimin e veprimtarisë së biznesit me implementimin e politikave të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) Prezantimin e shoqërisë përpala palëve të treta;
- c) Mbikqyrjen e mbajtjes së Librave të Kontabilitetit dhe dokumenteve të tjera të nevojshme;
- d) Përgatitjen dhe nënshkrimin e Pasqyrave Financiare, Llogarive të Konsoliduara dhe raportin vjetor të përformancës së shoqërisë, si dhe paraqitjen e dokumenteve në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme për miratim së bashku me propozimin dhe shpërndarjen e sitimeve;
- e) Krijimin e një sistemi paralajmërues për zhvillimet që mund të cënojnë shoqerinë;
- f) Raportimin në Asamblenë e Përgjithshme mbi implementimin e politikave të të bërit biznes dhe realizimin e transaksioneve me rëndësi të vecantë për performancën e shoqërisë;
- g) Kryerjen e detyrate të parashikuara nga ligji osc Statuti;
- h) Përsaqësimin e Shoqërisë përpala çdo institucioni publik apo privat, financiar, jo-financiar, organi publik apo privat, organi tatimor, administrativ, gjyqësor, prokurori, etj.

9.8. Administratori ruan konfidencialitetin e të gjithë informacionit pronësor dhe sensitiv në lidhje me sekretet tregtare, të dhënat financiare, planet e biznesit, strategjitë e marketingut, formulimet e produkteve, listat e klientëve, informacionin e çmimeve dhe çdo informacion tjetër që nuk njihen nga të tjerët.

9.9. Administratori nuk duhet të zbulojë informacione konfidenciale kundrejt asnjë pale të tretë dhe as nuk do t'i përdorë këto informacione për ndonjë qëllim tjetër përvëç përfitimit të shoqërisë, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga Asambleja e Përgjithshme. Gjithashtu duhet të ushtrojë kujdesin e duhur dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur informacionin konfidencial nga aksesi, zbulimi ose keqpërdorimi i paautorizuar.

9.10. Administratori duhet të respektojë dhe mbrojë të drejtat e pronësise intelektuale të shoqërisë, duke përfshirë markat tregtare, të drejtat e autorit dhe patentat, dhe nuk do të përdorë ose zbulojë një pronë të tillë intelektuale pa autorizimin paraprak me shkrim nga Asambleja e Përgjithshme.

8.11. Administratori mund të autorizojë palë të treta për kryerjen e veprimeve të ndryshme, të tillë si: depozitimin e Pasqyrave Financiare në Qendrën Kombëtare të Biznesit, përsaqësimin e Shoqërisë para institucioneve shtetërore, etj., përvëç rasteve të parashikuara si kompetencë ekskluzive e Administratorit nga ligji ose ky Statut.

KREU III
MBARIMI, LIKUIDIMI, TË NDRYSHME

NENI IX

Mbarimi

- 9.1. Shoqëria mbaron:
 - a) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
 - b) me çeljen e procedurës së falimentimit;
 - c) nëse nuk ka kryer veprimtari biznesi për 2 (dy) vjet dhe nuk ka njofuar më parë statusin inaktiv sipas ligjit “*Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*”; ose
 - d) me vendim gjyqësor.
- 9.2. Administratori ose çdo person i autorizuar prej tij do të depozitojë raportin e mbarimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me ligjin Nr.9723 “*Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*”, të ndryshuar.

NENI X

Likuidimi

- 10.1. Pas vendimit për mbarimin e Shoqërisë, do të hapet procedura e likuidimit, përvç rasteve kur ka filluar një procedurë falimentimi.
- 10.2. Për kryerjen e procesit të likuidimit, Asambleja e Përgjithshme emëron 1 (një) ose disa likuidues, për qëllim hartimin e raportit të aktiveve dhe detyrimeve të shoqërisë, deri në mbarim të procesit të likuidimit.
- 10.3. Procesi i likuidimit do të bëhet në përputhje me ligjin 9901 “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*”, i ndryshuar.
- 10.4. Pas pagesës së likuiduesve, kapitali i mbetur i Shoqërisë do t'i shpërndahet Asamblesë së Përgjithshme.

NENI XI

Viti Financiar, Kontrolli Financiar, Bilanci Vjetor dhe Dividenti

- 11.1. Viti finanziar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti. Përjashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në QKB dhe mbyllet më 31 dhjetor.
- 11.2. Kontrolli finanziar i Shoqërisë kryhet në përputhje dhe sipas legjislativit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërcohët në bazë të ligjit.
- 11.3. Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme reportin mbi administrimin e Shoqërisë, si dhe llogaritë vjetore.
- 11.4. Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin finanziar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vittit finanziar.
- 11.5. Pasi të janë përmbrushur kërkesat e përcaktuara nga ligji “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave të ortakëve zotëruesh të kuotave me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme, mund të vendosë shpërndarjen e dividentëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- 11.6. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që i bashkëngjiten kuotave, të gjithë dividentët duhet të deklarohen dhe paguhen sipas shumave të paguara në kuotat në të cilat paguhet dividenti. Të gjithë dividentët do të shpërndahen dhe paguhen në mënyrë proporcionale me shumat e paguara mbi kuotat gjatë çdo pjese ose pjesëve të periudhës në të cilën paguhet dividenti.

NENI XII

Të ndryshme

- 12.1. Të gjitha situatat që nuk parashikohen nga ky Statut do të rregullohen nga ligji shqiptar Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.
- 12.2. Të gjithë dokumentet për palët e treta, të tillë si njoftime, publikime, dhe faturime etj., do të pëfshijnë emrin e Shoqërisë së bashku me shkurtimet “Sh.p.k.”, selinë, emrin e administratorit ose të të autorizuarit prej tij.
- 12.3. Bazuar në ligjin “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme do të regjistrohen në Regjistrin e mbajtur për këtë qëllim.
- 12.4. Shoqëria ka të drejtë të punësojë punëmarrës për të ushtruar aktivitetin e saj duke zbatuar parashikimet e Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.
- 12.5. Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të ortakëve ose ortakëve të tjera dhe/ose Shoqërisë, që kanë për objekt të drejta të lidhura me Shoqërinë, do të zgjidhen me marrëveshje ndërmjet

palëve të interesuara. Në rast se palët nuk arrijnë një zgjidhje miqësore jashtë gjyqësore, Gjykata e Rrethit Giyqësor Tiranë do të jetë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. 12.6. Ky statut është i draftuar në 3 (tre) kopje origjinale me fuqi të njëjtë juridike.

NENI XIII

Miratimi

13.1 Statuti i Shoqërisë tregtare, "Xhinos" sh.p.k. Tiranë, pasi lexohet nen për nen nga ortaku i vetëm dhe është plotësisht dakort me të, në kuadrin ligjor të organit vendimmarrës e miraton duke e nënshkruar.

"Xhinos" Sh.p.k.

Ortaku

ABIGAIL PLATTS *Anja Flus*

Shoqëria

"Sada Platts Group" Sh.p.k.

Administratori

Znj. Abigail Joyce Platts

Abigail Platts
Abigail Platts

